



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
MINISTRIA E POLITIKËS SOCIALE, DEMOGRAFISË DHE TË RINJVE

THIRRJE PUBLIKE PËR SIGURIMIN E MJETEVE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE
SOCIALE NGA KOMUNAT, QYTETI I SHKUPIT DHE KOMUNAT NË QYTETIN E
SHKUPIT

Bazuar në nenin 140 paragrafi 1 të Ligjit për mbrojtje sociale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 104/19, 146/19, 275/19, 302/20, 311/20, 163/21, 294/21, 99/21, 236/22, 65/23 dhe 192/25) Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë publikon thirrje publike për sigurimin e mjeteve për ofrimin e shërbimeve sociale NGA KOMUNAT, QYTETI I SHKUPIT DHE KOMUNAT NË QYTETIN E SHKUPIT, që do të realizohen në bashkëpunim me ofrues të licencuar të shërbimeve, me mbështetje financiare nga Ministria, dhe për grupet e cënueshëm të qytetarëve për të cilat është përcaktuar nevoja për një lloj të caktuar shërbimi.

РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
РЕПУБЛИКА E MAQEDONISË SË VERIUT
МИНИСТЕРСТВО ЗА СОЦИЈАЛНА ПОЛИТИКА,
ДЕМОГРАФИЈА И МЛАДИ - ГРОТЕ
MINISTRIA E POLITIKËS SOCIALE E
DEMOGRAFISË DHE E TË RINJVE - SHKUP

1. Lloji i shërbimeve:

Бр. / Nr. 23-12-2025 10-8269/1
23-12-2025 20 год. / III

Me Thirrjen publike sigurohen mjete për komunat për sigurimin e _____ 20 ____ год. / III

1. Shërbimeve në shtëpi:

asistencë personale dhe
ndihmë dhe përkujdesje në shtëpi

2. Shërbime në komunitet:

qendër për qëndrim ditor për personat me aftësi të kufizuara
qendër për qëndrim ditor për personat me aftësi të kufizuara me punë individuale
qendër për qëndrim ditor për personat e moshuar
qendër për qëndrim ditor për personat e moshuar për plakje aktive
qendër për rehabilitim dhe ri-integrim të personave me aftësi të kufizuara

2. Lartësia e mjeteve që ndahen dhe periudha kohore në të cilën do të jepen shërbimeve sociale

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë do të sigurojë mjete për ofrimin e shërbimeve sociale nga ana e komunave në bashkëpunim me ofruesin e licencuar të shërbimit, sipas çmimit të shërbimit të përcaktuar me Vendimin për përcaktimin e çmimeve të shërbimeve sociale në shtëpi, për mbrojtje jashtë-familjes, për ndihmë dhe mbështetje profesionale, për qëndrim ditor, për qëndrim të përkohshëm, për këshillim dhe zëvendësim të kujdesit familjar për vitin 2026, të miratuar nga ministri i Politikës sociale, Demografisë dhe Rinisë nr. 02-8269/1 datë 22.12.2024, të përpiluar në përputhje me Metodologjinë për formimin e çmimeve të shërbimeve në varësi të normave dhe standardeve për ofrimin e shërbimit social (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 264/19). Për komunat me ofrues të licencuar të shërbimeve sociale që kanë lidhur Kontratë administrative për vitin 2025 për shërbimin social ndihmë dhe



përkujdesje në shtëpi, në vitin 2026 do të sigurohen mjete për të njëjtin numër kujdestarësh për të cilët ishin financuar më parë. Mjetet do të sigurohen për çdo përfitues në baza mujore, për të cilët Qendra për Punë Sociale ka nxjerrë aktvendim, në periudhën prej 01.01.2026 deri më 31.12.2026.

3. Dokumente të nevojshme

Nëse shërbimi social realizohet nga Qendra për shërbime sociale e themeluar nga komuna, dorëzohen dokumentet në vijim:

1. Fletëparaqitje (Formular për aplikim për sigurimin e shërbimeve, të publikuar në ueb faqen e Ministrisë www.mtsp.gov.mk), të nënshkruar dhe verifikuar nga kryetari i Komunës,
2. Program për ofrimin e shërbimit social dhe përshkrim të hollësishëm të aktiviteteve me plan konkret të punës për implementimin dhe periudhën e realizimit të programit për ofrimin e shërbimit social për të cilën kërkohen ndarja e mjeteve, emri i plotë dhe adresa e subjektit i cili realizon programin për ofrimin e shërbimit social;
3. dokument nga partneriteti i realizuar, bashkëpunimi ndërsektorial dhe bashkëfinancimi i siguruar (nëse ka)
4. Të dhëna kontakti për personin përgjegjës/koordinatorin për realizimin e programit për ofrimin e shërbimit social (emri, mbiemri, e-mail adresa dhe numri i telefonit) dhe lista e të dhënave për kuadrin profesional dhe personave të angazhuar për ofrimin e shërbimit social,
5. Deklaratë nga komuna se nuk ka marrë mjete tjera për ofrimin e shërbimit;
6. Raport Vjetor për punë për vitin e mëparshëm dhe llogari përfundimtare për vitin paraprak të Qendrës për shërbime sociale;
7. Plan vjetor për mjete materiale dhe financiare për ofrimin e shërbimit të Qendrës për shërbime sociale

Komuna, për Qendrën për shërbime sociale që është themeluar në vitin aktual kur publikohet thirrja publike, nuk i dorëzon dokumentet nga pikat 6 dhe 7.

Nëse shërbimi social realizohet përmes bashkëpunimit të realizuar të komunës me ofruesin e licencuar të shërbimeve sociale, bashkëngjiten dokumentet në vijim:

1. Fletëparaqitje (Formular për aplikim për sigurimin e shërbimeve, të publikuar në ueb faqen e Ministrisë www.mtsp.gov.mk), të nënshkruar dhe verifikuar nga kryetari i Komunës,
2. Marrëveshje për bashkëpunim me ofrues të licencuar social (origjinal ose kopje e verifikuar në noter);
3. Program për ofrimin e shërbimit social dhe përshkrim të hollësishëm të aktiviteteve me plan konkret të punës për implementimin dhe periudhën e realizimit



- të programit për ofrimin e shërbimit social për të cilën kërkohen ndarja e mjeteve, emri i plotë dhe adresa e subjektit i cili realizon programin për ofrimin e shërbimit social;
4. Raport Vjetor për punë për vitin paraprak të ofruesit të licencuar të shërbimeve sociale për shërbimin konkretë, gjegjësisht për vitin 2024;
 5. Vërtetim për tatime të paguare, të lëshuar nga organet tatimore të ofruesit të licencuar të shërbimeve sociale jo më të vjetër se gjashtë muaj (origjinal ose kopje të verifikuar në noter);
 6. Të dhëna të kontaktit për personin përgjegjës/koordinatorin për realizimin e programit për ofrimin e shërbimit social (emri, mbiemri, e-mail adresa dhe numri i telefonit);
 7. Listë e kuadrit profesional dhe personave të angazhuar për ofrimin e shërbimit social;
 8. Deklaratë e ofruesit të licencuar të shërbimeve sociale të verifikuar në noter se nuk ka fituar mjete nga autoriteti tjetër shtetëror ose njësia e vetëqeverisjes lokale për aktivitetet e njëjta për ofrimin e shërbimit;
 9. Aktvendim për ofrimin e lejes për kryerjen e punës në kujdesin social dhe të gjitha ndryshimet shtesë të tij (origjinal ose kopje e verifikuar në noter).
 10. Dëshmi për mekanizmin e vendosur për kontrollin e cilësisë dhe sistemit të ankesave nga klientët (formularë).

Ofruesi i licencuar i shërbimeve që ka marrë leje për punë gjatë vitit aktual kur realizohet thirrja publike, nuk i dorëzon dokumentet nga pikët 4 dhe 5.

4. Afatet për zbatimin e procedurës

Thirrja publike zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit në ueb faqen e Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë.

Komunat e interesuara fletëparaqitjet i dorëzojnë përmes arkivit të Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë në adresën rr. "Dame Gruev" nr. 14, Shkup, në zarf të mbyllur, me shënim "për Thirrje publike për sigurimin e mjeteve për ofrimin e shërbimeve sociale nga komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit për vitin 2026".

Fletëparaqitjet që do të parashtrohen pas këtij afati dhe me dokumentacion jo të plotë nuk do të shqyrtohen.

Komisioni për sigurimin e mjeteve, në afat brenda 30 ditësh nga dita e parashtrimit të fletëparaqitjes, i përpilon mendim ministrit të Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë pas procedurës së zbatuar në përputhje me Ligjin për mbrojtje sociale dhe Rregulloren për kushtet më të afërta për ndarjen e mjeteve, për shkallën e pikëve dhe mënyrën e ofrimit të shërbimeve sociale nga komunat (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 163/22, nr. 269/2022).



Ministri i Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë pas marrjes së mendimit nga ana e Komisionit për sigurimin e mjeteve për shërbime sociale nga komunat dhe ofruesit tjerë miraton aktvendim për ndarjen e mjeteve.

Ministri i Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë do të lidhë Kontratë administrative me komunën dhe ofruesin e licencuar të shërbimit, me të cilin rregullohen të drejtat reciproke, obligimet dhe përgjegjësitë në realizimin e mjeteve të dhëna, në afat brenda 15 ditësh nga dita e finalizimit të aktvendimit për ndarjen e mjeteve.

Komunat që do të fitojnë mjete nga ana e Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë kanë obligim që të gjitha materialet (të shtypura dhe elektronike) që do të prodhohen në kuadër të realizimit të shërbimit në vend të dukshëm të qëndrojnë:

Mbështetur nga:



Република Северна Македонија

Republika e Maqedonisë Veriut
MINISTRIA E POLITIKËS SOCIALE, DEMOGRAFISË DHE TË RINJVE